Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

PËR VITIN 2019

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Arvita Zyferi-Hashani, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Arta Kryeziu-Qehaja udhëheqëse ekipi, Florë Berisha dhe Shefkije Beka (anëtare), nën menaxhimin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit....5

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore....6

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli....8

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve....16


Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja....19

Shtojca II: Komentet e KGjK-së në gjetjet e raportit të auditimit....21

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) për vitin 2019, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore të KGjK-së të prezantuara në Raportin Vjetor Financiar (RVF) për vitin 2019, që ndërlidhen me pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit dhe shpalosjet për këto pasqyra janë të plota dhe të sakta.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli në përgjithësi dëshmon një proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të kontrollit. Megjithatë, përkundër faktit se KGjK ka vendosur kontrolle relativisht të mira në raport me obligimet statutore të saj, mos zbatimi me konsistencë i rregullave, ka shkaktuar mangësi në disa procese.

KGjK i është përgjigjur pozitivisht rekomandimeve të vitit paraprak, ku është vërejtur një angazhim i shtuar në zbatimin e tyre.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm[1]

Opinion i pamodifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk është pajtuar me çështjen A1 dhe A4 të raportit. Komentet e KGjK-së për çështjet që nuk janë pajtuar janë dhënë në detaje në Shtojcën II.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të KGjK- së gjatë procesit të auditimit.

[1] Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK), për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Drejtori i Sekretariatit të KGjK dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime)dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi i KGjK është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontest të sistemeve financiare, në KGjK kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë zbatuar në mënyrë efektive, mirëpo në disa raste kemi identifikuar mangësi që kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë personeli, prokurimi dhe pasuria.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[2]	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**29,404,466**	**29,885,324**	**28,529,735**	**95**	**27,693,591**	**19,602,402**
Granti i Qeverisë – Buxheti	27,475,608	27,379,990	26,753,166	97	26,047,587	19,411,317
Të bartura nga viti paraprak[3]–		641,268			670,938	5,342
Të hyrat vetjake[4]	1,703,858	1,703,858	1,638,087	96	891,790	176,743
Të hyrat nga AKP	225,000	0	0			
Donacionet e jashtme		160,208	138,482	86	83,276	9,000

[2] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.
[3] Të hyrat vetjake të KGJK të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.
[4] Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 480,858€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura për 641,268€, rritje nga donacionet e jashtme 160,208€, dhe zvogëlim i buxhetit me vendime të Qeverisë për 320,618€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**29,404,466**	**29,885,324**	**28,529,735**	**95**	**27,693,591**	**19,602,402**
Pagat dhe Mëditjet	22,727,041	24,364,578	23,675,247	97	22,557,422	14,622,640
Mallrat dhe Shërbimet	4,583,925	4,208,758	3,769,785	90	3,819,098	3,545,741
Shërbimet komunale	463,500	375,978	319,449	85	358,588	396,629
Subvencionet dhe Transferet	500,000	501,010	456,814	91	463,353	385,470
Investimet Kapitale	1,130,000	435,000	308,440	71	495,130	651,922

Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur në vijim:

- Buxheti final për paga ishte rritur për 1,637,537€ me vendime të Qeverisë.
    - Vendimi nr.03/115 i datës 17.12.2019, për ndarje dhe kursime në kategoritë e shpenzimeve të organizatave buxhetore rritje në vlerë 860,272€, për mbulimin e pagave të muajit dhjetor; dhe,
    - Rritja prej 640,256€ ishte nga të hyrat e bartura të vitit 2018, si dhe rritja prej 155,463€, nga donacionet e jashtme. Ndërsa, zvogëlimi prej 18,454€ ishte me aprovim nga Ministri i Financave me hyrjen në fuqi të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ku janë transferuar 8 zyrtarë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK).
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 375,167€. Kjo ishte bërë me vendimin e Qeverisë nr. 03/115 të datës 17.12.2019 për ndarje dhe kursime në kategoritë e shpenzimeve të organizatave buxhetore, ku buxheti për kategorinë Mallra dhe Shërbime ishte zvogëluar për 370,000€. Ndërsa, zvogëlimi prej 9,912€, ishte bërë me aprovimin nga Ministri i Financave për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ku siç u përmend edhe më lartë, janë transferuar 8 zyrtarë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në KPK. Po ashtu kishte një rritje prej 4,745€ nga donacionet.

- Buxheti final për Shërbime Komunale ishte zvogëluar për 87,522€. Ky zvogëlim ka rezultuar nga vendimi i Qeverisë nr.03/115 i datës 17.12.2019 për 87,000€, si dhe zvogëlimi prej 522€ me aprovimin nga Ministri i Financave.

- Buxheti final për kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve është rritur për 1,010€ nga të hyrat e bartura të vitit 2018.

- Buxheti final për kategorinë e Investimeve Kapitale ishte zvogëluar për 695,000€. Ky zvogëlim ishte përmes vendimit të Qeverisë nr.02/113 i datës 05.11.2019 për kursime dhe ndarje buxhetore.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga KGjK në vitin 2019 ishin në vlerë 7,602,279€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga gjobat nga gjykatat 3,805,457€, gjobat në trafik 791,616€, taksa e gjykatës 2,846,735€ dhe taksa tjera administrative 158,471€.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	2019 Pranimet	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat vetjake	7,602,279	7,928,116	7,708,641
Totali	**7,602,279**	**7,928,116**	**7,708,641**

Me ligjin e buxhetit për vitin 2019, KGjK-së ju është lejuar shfrytëzimi i të hyrave në vlerë prej 1,703,858€. Kemi testuar 73 mostra për teste substanciale në vlerë 108,580€, si dhe 24 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nuk kemi hasur në ndonjë mangësi.

2.1.2 Depozitat

KGjK, menaxhon edhe një fond të parave nga depozitat e gjykatave të cilat njihen si llogari e mirëbesimit. Në fund të vitit 2019 llogaria e mirëbesimit ishte 4,354,737€. Prej tyre 1,508,366€ ishin depozita të realizuara gjatë vitit 2019, kthime në vlerë 1,276,329€, ndërsa pjesa tjetër ishte saldoja nga vitet e kaluara. Kemi testuar 42 mostra për teste substanciale ku kemi përfshirë hyrje dhe kthime të depozitave dhe nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi.

2.1.3 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Paga dhe Mëditje në vitin 2019 ishte 24,364,578€, prej tyre ishin shpenzuar 23,675,247€, apo 97%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 2,289 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 2,026. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 108,580€, si dhe 24 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 –Mos harmonizim i pagesës me aktet e emërimit

Gjetja

Neni 11 i Rregullores Nr. 07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil përcakton se ndryshimet dhe plotësimet e aktit të emërimit bëhen me një aneks (formular) që i bashkëngjitet akt emërimit.

Në dhjetor të vitit 2017, KGjK kishte marrë vendim që të bëj harmonizimin e pagave/koeficienteve të punonjësve mbështetës në sekretariat dhe gjykata. Pavarësisht ndryshimeve që ishin bërë (rritjet e pagave) KGjK nuk kishte bërë ndryshimet e akt emërimeve në pajtim me vendimin. Në dhjetë raste zyrtarët paguheshin me koeficient më të lartë në raport me atë që parashihej në akt emërim.

Kjo kishte ndodhur për shkak të neglizhencës së departamentit të burimeve njerëzore për t'i azhurnuar akt emërimet e të punësuarve në pajtim me vendimin e nxjerrë nga këshilli.

Ndikimi

Mos azhurnimi i akteve të emërimit të të punësuarve nga ana burimeve njerëzore ka ndikuar në mos-harmonizimin e pagave mes akt emërimit dhe vendimit.

Rekomandimi A1

Kryesuesi i KGjK-së të siguroj se departamenti i burimeve njerëzore do të bëj azhurnimin (ndryshimin) e akt emërimeve në pajtim me vendimin e nxjerrë nga këshilli.

Çështja A2 -Mungesa e evidencave për vijueshmëri në punë

Gjetja Neni 7 paragrafi 1 i rregullores nr. 05/2010 e orarit të punës në shërbimin civil përcakton se "Gjatë orarit të punës të gjithë nëpunësit civil janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo nëpunës civil shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik".

Në katër raste që kanë të bëj me gjykatën themelore të Prizrenit, ne nuk kemi mundur të sigurojmë dëshmi për vijueshmëri në punë për stafin civil. Mungesën e dëshmive për vijueshmëri KGjK e arsyeton me problemet që kishte sistemi elektronik i vijueshmërisë mirëpo në të njëjtën kohë ata nuk kanë ofruar dëshmi të mbajtjes së evidencës në librin e vijueshmërisë ashtu siç kërkohet me rregullore.

Ndikimi Mungesa e dëshmive të cilat konfirmojnë praninë e zyrtarëve në punë, mund të ndikoj në kryerjen e pagesave për zyrtarët të cilët fare nuk kanë punuar.

Rekomandimi A2 Kryesuesi i KGjK-së duhet të siguroj funksionimin e sistemit elektronik të vijueshmërisë, ndërsa në rast të mos funksionimit të mbahen evidenca të vijueshmërisë në formë fizike në mënyrë që të dëshmohet prezenca e punonjësve në punë.

Çështja A3–Parregullsi gjatë procesit të rekrutimit

Gjetja Neni 34 paragrafi 4 i Rregullores nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, përcakton që pas përfundimit të testimeve me shkrim dhe me gojë, kryesuesi i komisionit përgatit për menaxherin e personelit një raport të shkurtër me shkrim ku përcaktohet vendi, emrat e kandidatëve, emrat e komisionit pikët e fituara dhe raportin përfundimtar të kandidatëve i cili paraqet pikët e përgjithshme të kandidatëve.

Kemi vërejtur se në Gjykatën Themelore të Mitrovicës për konkursin e punësimit për pozitën "zyrtar për përkthime" kryesuesi i komisioni përzgjedhës nuk kishte përgatit për menaxherin e personelit një raport të shkurtër me shkrim ashtu siç kërkohet me rregullore.

Ndikimi Mos përgatitja e raportit nga kryesuesi i komisionit përzgjedhës për menaxherin e personelit mund të ndikoj në një pasqyrim jo të qartë në lidhje me mbarëvajtjen e procesit e rekrutimit.

Rekomandimi A3 Kryesuesi i KGjK-së të siguroj se procedurat e rekrutimit zbatohen në përputhje me rregulloren në fuqi ku pas çdo procesi të testimit dhe intervistimit do të përgatitet raporti me shkrim për menaxherin e personelit.

2.1.4 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime(përfshirë shërbimet komunale) në vitin 2019 ishte 4,584,736€, prej tyre ishin shpenzuar 4,089,234€ apo 89%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet e përfaqësimit dhe avokaturës, derivateve, qirasë, komunalive, shërbime postare dhe shpenzime tjera. Kemi testuar 40 mostra për teste substanciale në vlerë 180,592€ si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë. Përmes testimeve tona kemi vërejtur mangësinë në vijim:

Çështja A4 – Ndarje jo e duhur e detyrave

Gjetja Sipas nenit 62. paragrafi 3.4 Rregullat Dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RrUOPP) përcakton se 'zyrtari i cili ka përgatitur specifikimet nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit të vlerësimit'. Gjithashtu sipas nenit 62. paragrafi 3.7 ''Një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i projektit''. Tek procedura e prokurimit "Ofrimi i trajnimeve në fushën e TIK për stafin e TI", zyrtari i cili kishte përgatitur specifikat ishte caktuar anëtar i komisionit për vlerësimin e tenderëve dhe po ashtu menaxher i projektit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kujdesit jo të duhur me rastin e formimit të komisionit dhe caktimit të menaxherit të kontratës.

Ndikimi Ndarja jo e duhur e detyrave dhe përgjegjësive ndikon në reduktimin e kontrollin efektiv në procesin e prokurimit.

Rekomandimi A4 Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë se zyrtarët të cilët janë të përfshirë në hartimin e specifikave nuk caktohen në vlerësimin e tenderëve si dhe këta të fundit nuk mund të angazhohen në menaxhimin e kontratës.

2.1.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 501,010€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 456,814€ apo 91%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me kompensimin e të dënuarve pa bazë. Kemi testuar pesë mostra për teste substanciale në vlerë 16,660€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë. Përmes testimeve tona ne nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi.

2.1.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 435,000€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 308,440€ apo 71%. Ato kanë të bëjnë me renovime të Gjykatave. Kemi testuar gjashtë mostra për teste substanciale në vlerë 97,730€, si dhe tri mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale e paraqitur në RVF ishte 15,737,537€, ndërsa vlera e pasurive jokapitale apo nën 1,000€ ishte 1,293,439€, si dhe e stoqeve 320,616€. Kemi testuar 10 mostra për teste substanciale në vlerë 332,360€, si dhe në aspektin e pajtueshmërisë kemi vlerësuar nëse ministria ka vepruar në pajtim me kërkesat e rregullores për pasuri. Mangësitë e evidentuara janë prezantuar në vijim:

Çështja B1 – Mos inventarizim i plotë i pasurive në KGjK

Gjetja

Neni 18 i Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare paragrafi 3 parasheh që organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare si dhe neni 19 i kësaj rregullore parasheh përgatitjen e raportit për kryerjen e inventarizimit nga komisioni i inventarizimit.

Ne kemi vërejtur se komisionet e inventarizimit në tri gjykata[5] nuk e kishin kryer inventarizimin dhe rrjedhimisht nuk kishin përgatit raport që ndërlidhet me inventarizimin e pasurive.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së kontrolleve të duhura nga sekretariati dhe gjykatat për të siguruar harmonizimin dhe kryerjen e plotë të procesit të inventarizimit.

Ndikimi

Mos kryerja e plotë e inventarizimit nga KGjK mund të rezultojë në regjistra të pasaktë të pasurive si dhe prezantim të gabuar në Raportin Vjetor Financiar (RVF).

Rekomandimi B1

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të sigurohet që komisioni i inventarizimit para përgatitjes së RVF të bëj inventarizimin e të gjitha pasurive në KGjK dhe të përgatis raportin që ndërlidhet me procesin e inventarizimit.

2.3 Të arkëtueshmet

KGjK në PFV-të e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 135,926€. Këto llogari përbëhen nga vendimet e gjykatave për gjobat e trafikut, gjobat nga gjykatat, tarifat gjyqësore të cilat janë të pa realizuara deri në fund të vitit 2019 dhe si të tilla janë bartur për t'u inkasuar në vitin 2020. Kemi testuar pesë mostra për teste substantive në vlerë 9,500€ dhe nuk kemi hasur në mangësi.

[5] Gjykata themelore e Prishtinës, Pejës dhe Mitrovicës me degët e tyre.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 170,141€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Prej tyre 144,985€ ishin për mallra dhe shërbime, 12,351€ për shërbime komunale dhe 12,805€ për subvencione dhe transfere. Arsyeja e mos pagesës ishte pranimi i faturave kryesisht në muajin dhjetor. Më tutje, sipas shënimeve të ofruara nga KGjK, detyrimet kontraktuale ishin 1,028,123€[6]. Kemi testuar pesë mostra për teste substanciale në vlerë 7,226€, dhe pesë për teste të pajtueshmërisë dhe nuk kemi hasur në ndonjë mangësi për raportim.

2.4.2 Detyrimet kontingjente

KGjK ka prezantuar detyrime kontingjente në RVF në vlerë 18,481,176€. Këto janë detyrime potenciale për shkak të padive nga personat të cilët kanë qenë në burgim, paraburgim apo burg shtëpiak dhe janë liruar me vendim të gjykatës. Kemi testuar nëntë mostra për teste substanciale në vlerë 8,230,454€ nuk kemi hasur në ndonjë mangësi për raportim.

2.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) përbëhet nga Drejtori i Njësisë dhe tre auditorë. NjAB, ka përgatitur Planin Strategjik(2019-2021) dhe Planin Vjetor të cilët ishin aprovuar. Në Planin vjetor janë planifikuar tetë auditime të rregullta dhe ky plan ishte realizuar plotësisht. Aktivitetet audituese kanë mbuluar vitin 2018 dhe 2019, në fushën e shpenzimeve pa procedura të prokurimit, procedurat e avancimit dhe trajnimet e stafit, menaxhimi i transportit, raportimi i obligimeve të pa paguara, menaxhimi i të hyrave, shpenzimet postare si dhe përcjellja e implementimit të rekomandimeve. Numri i rekomandimeve të dhëna gjithsej ishte 60, prej tyre 47 ishin zbatuar ndërsa 13 ishin në proces.

NjAB, kishte raportuar në baza të rregullta në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm. Komiteti i Auditimit ishte formuar në shtator 2019, dhe kishte mbajtur një takim ku ishin diskutuar raportet e NjAB-së.

[6] Kjo shumë është ofruar nga entiteti i audituar.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka rezultuar në tre rekomandime. KGjK kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna, si dhe ka dorëzuar raportet e progresit mbi zbatimin e kërkesave të dala nga rregullorja e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019 nga tre rekomandimet e dhëna, KGjK kishte arritur të zbatoj dy rekomandime dhe një ishte i pa zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Çështje të përbashkëta	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të siguroj që para fillimit të procedurave të prokurimit janë kërkuar dhe pranuar kërkesa të miratuara nga Gjykata për nevoja reale të tyre.	Menaxhmenti ka arritur që për të gjitha aktivitetet e prokurimit te hartoj paraprakisht projekte zbatuese para fillimit te procedurave.	I zbatuar
2.	Pasuritë Jo financiare	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të sigurohet që para përgatitjes së PFV është bërë inventarizimi i plotë duke u harmonizuar me regjistrat përkatës.	Përkundër angazhimit te një komisioni i cili ka mbikëqyrur punën dhe ka këshilluar komisionet e inventarizimit edhe këtë vit tri gjykata nuk kanë përfunduar inventarizimin.	I pa zbatuar
3.	Auditimi i Brendshëm	Kryesuesi i KGjK-së dhe Drejtori i SKGjK-së duhet të siguroj themelimin e komitetit të auditimit	KGJK në shtator të vitit 2019 ka arritur të formoj komitetin e auditimit.	I zbatuar
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
A1	Mos harmonizim i pagesës me aktet e emërimit	Kryesuesi i KGjK-së të siguroj se departamenti i burimeve njerëzore do të bëj azhurnimin (ndryshimin) e akt emërimeve në pajtim me vendimin e nxjerr nga këshilli.		

A2	Mungesa e evidencave për vijueshmëri në punë	Kryesuesi i KGjK-së duhet të siguroj funksionimin e sistemit elektronik të vijueshmërisë, ndërsa në rast të mos funksionimit të mbahen evidenca të vijueshmërisë në formë fizike në mënyrë që të dëshmohet prezenca e punonjësve në punë.
A3	Parregullsi gjatë procesit të rekrutimit	Kryesuesi i KGjK-së të siguroj se procedurat e rekrutimit zbatohen në përputhje me rregulloren në fuqi ku pas çdo procesi të testimit dhe intervistimit do të përgatitet raporti me shkrim për menaxherin e personelit.
A4	Ndarje jo e duhur e detyrave	Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë se zyrtarët të cilët janë të përfshirë në hartimin e specifikave nuk caktohen në vlerësimin e tenderëve si dhe këta të fundit nuk mund të angazhohen në menaxhimin e kontratës
B1	Mos inventarizim i plotë i pasurive në KGjK	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të sigurohet që komisioni i inventarizimit para përgatitjes së RVF të bëj inventarizimin e të gjitha pasurive në KGjK dhe të përgatis raportin që ndërlidhet me procesin e inventarizimit

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose

individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Komentet e KGjK-së në gjetjet e raportit të auditimit

Gjetjet/ çështjet	**Pajtohemi po/jo**	**Komentet e OB-së në rast të mospajtimit**	**Pikëpamjet e ZKA-së**
Çështja A1: Mos harmonizimi pagës me aktet e emërimit	Jo	Pas kthimit të kompetencave me 1 gusht 2019 Departamenti i Administratës së Përgjithshme është duke evidentuar te gjitha rastet e tilla dhe duke vendosur ne dosje personale Vendimin DASHC/MAP – 04/32 Për procedim ne listën e pagave. Ne secilën dosje, përveç Vendimit te Këshillit është vendosur edhe nga një kopje e Vendimit te MAP për aprovimin e koeficienteve ne harmoni me ata te KPK-se. Arsyeja e mos ndryshimit e akt emërimeve lidhet edhe me hyrjen ne fuqi te Ligjit për Paga dhe ndërkohë Vendimit te Gjykatës Kushtetuese për pezullim te ligjit. Pas aktgjykimit, SKGJK do te ndërmerr te gjithë hapat lidhur me azhurnimin e akt emërimeve sipas legjislacionit ne fuqi.(ju lutem gjeni vendimin e bashkangjitur)	Vendimi nga KGJK për harmonizimin e pagave ishte marrë në dhjetor të vitit 2017, dhe që prej atëherë KGjK nuk ka ndryshuar akt emërimet e këtyre të punësuarve në mënyrë që pagat e marra të jenë të harmonizuara me akt emërime. Prandaj komenti i bërë nga KGjK është vetëm arsyetim pa ofruar ndonjë dëshmi relevante për ta ndryshuar gjetjen tonë dhe si rezultat e gjetura dhe rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.

Çështja A4: Ndarje jo e duhur e detyrave	Jo	Deri te lëshimi teknik çdo kërkese për zhvillimin e aktivitetit te prokurimit vjen e nënshkruar nga Drejtorët e Departamenteve, ose Shefat e Zyrave të SKGJK-se, por asnjëherë nga zyrtaret, kjo ka qene arsyeja e lëshimit gabim teknik. Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Neni 3 përjashtimet pika 6 ky ligj nuk zbatohet për një kontrate te punësimit, nëse aktiviteti i tille i prokurimit është lende e rregullave te tjera qe vendosen me një ligj ose rregullore tjetër. Njëjte, ligji aktual nuk do te aplikohet për kontratat në lidhje me trajnimet pasuniversitare apo trajnime profesionale nga punëdhënësi për zhvillimin e aftësive specifike të punëtorëve individualë. Për më shumë, ligji nuk do të aplikohet në prokurim ekskluzivisht të orientuar në përfaqësimin në formë të ofrimit të ushqimit dhe pijeve. Andaj, Autoriteti kontraktues : Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka pas mundësi të bëjë një Marrëveshje në Bashkëpunimit, me një nga Institucionet në Republikën e Kosovës, të cilat ofrojnë Trajnimeve profesionale në fushën e TIK, për stafin e TI, të KGJK-së pa zhvilluar fare procedure të hapur të prokurimit. Përkundrazi Auoriteti Kontraktues :Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës Zyra e Prokurimit, ka respektuar ne tërësi Ligjin Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË	Është i qartë fakti se përkundër mundësisë që e lejon Ligji i prokurimit që shpenzimet e tilla të përjashtohen nga procedurat e këtij ligji, KGjK kishte vendosur që për hir të transparencës të aplikojë procedurë të hapur të prokurimit. Megjithatë, me rastin e aplikimit të procedurave të prokurimit, ato duhet të aplikohen sipas kërkesës ligjore në mënyrë që të shmangen autorizimet e proceseve të ndryshme nga të njëjtit zyrtarë. Kjo ndikon në siguri më të lartë të proceseve në kontrollet e brendshme të institucionit. Prandaj, e gjetura dhe rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.

		KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Neni1 Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat qe do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat , operatorët ekonomik , ndërmarrjet , autoritetet kontraktuese, koncesioneve e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjese ose interesohen, ne aktivitetet e prokurimit ose qe përfshihen ose kane te bëjnë me fondet dhe / ose burimet e tilla. Nni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti . Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike të përdoren në mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marre ne konsiderate qëllimin dhe lenden e prokurimit. 2.Fondet publike dhe burimet publike qe janë ofruar ose qe janë vene ne dispozicion sipas nje kontrate publike mund te perdoren vetëm për qëllimet e te njëjtës. Neni 7	

		Barazia në trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues SKGJK, ka trajtuar operatoret ekonomik ne menyre te barabarte dhe jo-diskriminuese dhe do te veproje ne menyre transparente.2. Autoriteti kontraktues SKGJK, nuk do te ekzekutoje asnjë aspekt te aktivitetit te prokurimit ne nje menyre qe redukton apo eliminon konkurrencën ne mes te operatoreve ekonomik ose qe diskriminon ne dem ose ne te mirë te nje ose me shume operatoreve ekonomik. Neni 10 Mjetet per promovimin e Transparences 1. Autoriteti kontraktues mban nje përmbledhje te rregulluar dhe gjithëpërfshirëse te te dhënave per secilin aktivitet te prokurimit qe e kryen, pa marre parasysh nëse aktiviteti i tille rezulton ne dhënien e kontratës ose konkursit te projektimit. Ruajtja e dokumenteve përkatëse behet sipas legjislacionit ne fuqi per Arkivat shteterore. Dhe Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve.	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

I të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");

- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Draft Raportit **përveç çështjes/gjetjes A1 dhe A4** si dhe

- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Skender Çoçaj.....

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Data: 13 Korrik 2020, Prishtinë.